

VENDIM
Nr. 577, datë 29.8.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, të shtohen personat e renditur në listën “a”, “Lista e shtuar e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për talibanët.

2. Nga lista e shkronjës “A”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, çregjistrohen personat e renditur në listën “b”, “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

3. Në fund të shkronjës “B”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”, shtohen kompanitë e renditura në listën “c”, “Lista e shtesave në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

4. Nga lista e shkronjës “C”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida” çregjistrohen personat e renditur në listën “d”, “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

5. Nga lista e shkronjës “D”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen kompanitë e renditura në listën “dh”, “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si kompani të çregjistruara me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha